**Tabela**

<table>
<tr><td colspan="2">32000L0031<br>Direktiva nr. 2000/31/KE, “Mbi disa aspekte ligjore të shërbimeve të Shoqërisë së Informacionit, veçanërisht mbi tregtinë elektronike në tregun e brendshëm” e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 8 qershor 2000.<br>OJ L 178, 17.7.2000, p. 1–16</td><td colspan="5">Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike” të ndryshuar”<br><br>Shkalla e përafrimit:<br>Përputhshmëri e pjesshme</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td></tr>
<tr><td>Neni</td><td>Teksti</td><td>Referenca</td><td>Neni</td><td>Teksti</td><td>Përputhshmëria</td><td>Shënime</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të *acquis* së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit. | Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë. | Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës | Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projekaktit | Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafruar kërkesat e nenit të *acquis* së BE-së në kolonën e dytë. | Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë. | Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafrimi i plotë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 17<br><br>Pg.1 | Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit<br><br>1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që, në rast të mosmarrëveshjes në mes të një ofruesi të shërbimit të shoqërisë së informacionit dhe një përfituesi të shërbimit, legjislacioni i tyre kombëtar nuk pengon përdorimin e skemave jashtë gjyqësorit, në dispozicion sipas ligjit kombëtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përfshirë mjetet e duhura elektronike. | | *Neni 12 Pg.1* | *Neni 12*<br><br>*Neni 24, "zgjidhja e mosmarrëveshjeve" riformulohet si më poshtë:*<br><br>*1. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, që rrjedhin nga hyrja në marrëdhënie me njëri-tjetrin, për shkak të ofrimit dhe të pranimit të shërbimeve në distancë, zgjidhen përmes ndërmjetësimit sipas legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin, nga gjykata e arbitrazhit, sipas klauzolave të arbitrazhit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.* | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 17, Pg.2 | 2. Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë organet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit, në veçanti për mosmarrëveshjet midis konsumatorëve për të vepruar në një mënyrë e cila ofron garanci adekuate, procedurale për palët e interesuara. | | Neni 12,<br><br>Pg.2 dhe 3 | *2. Në rast mungese të marrëveshjes për ndërmjetësim ose për arbitrazh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata e rrethit gjyqësor.*<br><br>*3. Ftesa për ndërmjetësim, e paraqitur nga një palë në mosmarrëveshje, nuk e pengon automatikisht këtë palë që të iniciojë fillimin e një procesi gjyqësor apo arbitrazhi në lidhje me këtë mosmarrëveshje, për shkak të kalimit të afateve të paraqitjes së padisë.* | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 17,<br><br>Pg.3 | 3. Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë organet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë-gjyqësorit për të informuar Komisionin, për vendimet e rëndësishme që ata marrin në lidhje me shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe për të transmetuar ndonjë informacion tjetër në praktikat, përdorimet  ose zakoneve të lidhura me tregtinë elektronike. | | | | E paaplikueshme | Pas anëtarësimit në BE. |